



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJILANIT



RREGULLORE PËR RRUGËT LOKALE

Gjilan, 2023

Në bazë të nenit 12, paragrafit 2, pika c të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (GZRK nr. 28, dt. 04.06.2008), nenit 5, paragrafit 2 të Ligjit nr. 2003/11 për Rrugë, nenit 3 paragrafit 2 të Ligjit nr. 03/L-120 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rrugë nr. 2003/11, dhe të nenit **xx**, paragrafi **xx**, të Statutit të Komunës së Gjilanit nr. **xx**, dt. **xx.xx.xxxx**, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në mbledhjen e mbajtur me **xx.xx.xxxx**, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR RRUGËT LOKALE

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet pozita juridike e rrugëve publike, projektimi, ndërtimi, rikonstruktimi, mirëmbajtja, masat mbrojtëse, menaxhimi, financimi, shfrytëzimi dhe mbikëqyrja e rrugëve lokale dhe atyre në vendbanime, si lloj i rrugëve publike, (më poshtë "rrugët lokale") në territorin e Komunës së Gjilanit (më poshtë "Komuna").

Neni 2

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

"Rikonstruktiv" i rrugës, nënkupton kryerjen e punimeve në rrugët ekzistuese dhe objektet e tjera përcjellëse. Me këto veprime ndërtohen elementet bazë të rrugës ose elementet konstruktive të objekteve përcjellëse (urave, viadukteve etj.), me qëllim të përmirësimit të elementeve të rrugës dhe ngritjes së nivelit të shërbimeve në rrugë;

"Transport i jashtëzakonshëm", nënkupton qarkullimin në rrugë publike të automjeteve me ngarkesë boshtore, masë apo dimensione përtej masave të parapara me standarde teknike;

"Mirëmbajtje", nënkupton përkujdesjen apo riparimin e rrugës dhe të objekteve të saj përkatëse ose të ndonjë pune tjetër të domosdoshme që të ruaj gjendjen e mirë të rrugës;

"Rrugë Magjistrale", nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë magjistrale, e cila lidhë dy e më tepër qytete dhe e cilat mund të shërbejnë si lidhje me rajonet jashtë Kosovës;

"Rrugë publike", nënkupton sipërfaqen me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, e cila mund të shfrytëzohet nga pjesëmarrësit në komunikacion sipas kushteve të shpallura nga organi kompetent;

"Rrugë urbane" nënkuptohet rruga publike që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune;

"Brezi rrugor" nënkupton brezin tokësor në të dy anët e rrugës nacionale dhe regjionale me gjerësi 2 (dy) metra, duke e matur nga pikat e skajshme të profilin tërthor të rrugës dhe nga skaji i jashtëm i kanalit për largim të ujërave, për rrugët lokale brezi rrugor është 1 (një) metër;

"Brezi mbrojtës rrugor" nënkupton brezin tokësor në të dy anët e rrugës në të cilin nuk lejohet ndërtimi i objekteve e që fillon nga skaji i jashtëm i brezit rrugor;

"Ndërtimi" nënkupton ndërtimin komplet të ri të rrugës dhe të objekteve të tjera përcjellëse të rrugës;

“Autoudhë” nënkupton rrugën publike posaçërisht të ndërtuar dhe destinuar vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme komunikacioni, e cila ka sipërfaqe qarkulluese të ndarë fizikisht për lëvizje nga drejtime të kundërta të shiritave me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e autostradës, me gjerësi së paku 2,5 metra;

“Organi përgjegjës për rrugë publike” nënkupton autoritetin administrativ përkatës të emëruar nga Ministria ose Komuna;

“Rrugë rajonale” nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve;

“Rrugë lidhëse” nënkupton rrugën publike e cila lidh vendbanimet me stacionet hekurudhore, rrugët për aeroport, banjë shëruese, qendra rekreative, parqet nacionale, etj.

“Rrugë e pa kategorizuar” nënkupton rrugë e cila nuk është caktuar si rrugë publike por shfrytëzohet për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga e liqeneve akumuluese, rruga për destinim bujqësor, e të ngjashme.

KREU II

RRUGËT PUBLIKE LOKALE

Neni 3

Rruga publike lokale është në përdorim të përgjithshëm dhe me interes për komunën.

Neni 4

4.1 Rrjetin e rrugëve e përbëjnë:

- a) rrugët në vendbanime,
- b) rrugët urbane,
- c) rrugët lidhëse dhe
- d) rrugët e pa kategorizuara

4.2 Rruga publike lokale përbëhet prej:

- a) konstruksionit të poshtëm dhe të epërm të rrugës;
- b) objekteve ndërtimore të rrugës (ura, lëshesa, tunele, galeri, mure mbrojtëse, etj.);
- c) trotuareve, shiritit për këmbësor dhe shiritit për biçikleta;
- d) kanaleve për largimin e ujërave nga rruga;
- e) brezit rrugor nga të dy anët në gjerësi prej dy metrave;
- f) elementeve përcjellëse të rrugës (parkingjet, vendndalimet e automjeteve, gjelbërimi, etj.);
- g) hapësirës ajrore mbi rrugët në lartësi prej 7,0 metra, profili i lirë mbi rrugët nacionale dhe regjionale në lartësi prej 4,50 metra kurse për autostrada 4,75 metra nga sipërfaqja qarkulluese;
- h) sinjalizimit horizontal, vertikal dhe semaforët;

- i) pajisjeve të rrugës (mbrojtësit elastik, mbrojtësit nga bora, rrjetat mbrojtëse, udhërrëfyesve, mjetet për matjen e transportit të jashtëzakonshëm të mjeteve motorike, pajisja për ajrosje, ndriçimi publik, etj.);
- j) pajisjeve për mbrojtjen e ambientit dhe pajisjeve për mbrojtje nga zhurma, etj.

Neni 5

5.1 Drejtoria e Shërbimeve Publike (në tekstin në vazhdim "Drejtoria") është kompetente për rrugët publike lokale.

5.2 Drejtoria mban një regjistër, i cili përmban evidencën e të gjitha rrugëve publike lokale.

5.3 Drejtoria është e obliguar ta informojë Kuvendin për kryerjen dhe kategorizimin e rrugëve.

Neni 6

6.1 Drejtoria sipas kompetencës që ka, mund:

- a) të caktojë rrugë të veçanta për qëllime të veçanta;
- b) të ndajë një kategori të veçante të rrugëve në nën-kategori.

6.2 Sipas destinimit të tyre, rrugët publike lokale mund të dedikohen për pjesëmarrës në qarkullim (për automjete motorike, biçikleta, këmbësore dhe shfrytëzues të tjerë), ose vetëm për automjete motorike.

6.3 Drejtoria mund të kategorizoj ndonjë rrugë ekzistuese të pakategorizuar, si rrugë publike lokale.

6.4 Drejtoria e bën kategorizimin e rrugëve sipas funksionit të tyre, në:

- a) Rrugët urbane - janë rrugët të cilat kanë funksionin e rrugëve kryesore, që janë me kapacitet dhe qarkullim të lartë të trafikut, të cilat zakonisht janë rrugë me shumë shirita për qarkullim (sipas destinimit të tyre sipas paragrafit 6.2 të këtij neni), por që këto rrugë gjenden dhe shërbejnë për qarkullim brenda zonës urbane.
- b) Rrugët në vendbanime - janë rrugët të cilat kanë funksionin e rrugëve që shërbejnë direkt në vendbanim apo lagje ku ndodhen dhe kanë karakter lidhës me rrugët e kategorive të tjera.
- c) Rrugët lidhëse - janë rrugë të cilat kanë funksione hyrës dhe dalës nga zonat urbane, vendbanimet apo lagjet, të cilat shërbejnë për trafikun ndërmjet zonës urbane dhe vendbanimeve tjera, si dhe mund të kenë rolin e rrugëve transite të qytetit.

Neni 7

7.1 Drejtoria është përgjegjëse për menaxhimin e projektimit, ndërtimit, rikonstruktimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të rrugëve të kategorizuara sipas nenit 6.4 të kësaj rregulloreje.

7.2 Për detyrat sipas paragrafit 1 të këtij neni, drejtoria mund të kërkojë këshilla nga Ministria përkatëse.

Neni 8

8.1 Komuna, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, bën shpronësimin e çfarëdo pasurie të paluajtshme, si dhe objektet e lidhura me tokën, që nuk janë në pronësi të Komunës, marrja dhe

përvetësimi i pjesërishëm apo i tërësishëm i të cilave është i nevojshëm për ndërtimin, shfrytëzimin ose mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

8.2 Komuna duhet të kryejë shpronësimet sipas paragrafit 1 të këtij neni duke zbatuar Ligjin në fuqi për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

8.3 Drejtoria duhet ta njoftojë Drejtorinë për Buxhet dhe Financa me planin e punës për vitin e ardhshëm, me qëllim të evidentimit të pronave dhe shpronësimit të tyre.

Neni 9

9.1 Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale financohet nga të hyrat e buxhetit të Komunës (grantit të përgjithshëm) dhe nga kontributet e qytetarëve, përmes:

- a) tarifave për përdorimin e rrugëve,
- b) tarifave me koncesion,
- c) donacioneve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve.

KREU III MIRËMBAJTJA

Neni 10

Drejtoria në bashkëpunim me Bashkësinë Lokale, harton dhe nxjerr planin vjetor të mirëmbajtjes dimërore dhe verore për rrugët publike lokale.

Komuna informon Ministrinë mbi programin vjetor të ndërtimit të rrugëve lokale.

Neni 11

Drejtoria është përgjegjëse për vendosjen, rivendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në rrugët publike lokale.

Neni 12

Për mirëmbajtjen e rrugëve publike lokale Komuna mund të lidhë kontratë me kompani të përgjegjshme, të cilat janë lëndë e legjislacionit për prokurim publik.

KREU IV PROJEKTIMI, NDËRTIMI DHE RIKONSTRUKTIMI I RRUGËVE PUBLIKE

Neni 13

14.1 Drejtoria në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUPMM), zbaton rregulla për kriteret teknike për projektimin, ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve në autoritetin e vet, sipas ligjeve në fuqi për rrugët, ndërtimin dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.

13.1 Gjatë projektimit, ndërtimit, rikonstruktimit të rrugëve lokale, Bashkësia Lokale duhet ta informojë Drejtorinë në lidhje me kërkesat dhe problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti për rrugën për të cilën bëhet projektimi, ndërtimi, rikonstruktimi i rrugës lokale.

Neni 14

14.2 Drejtoria dhe pronarët e rrugëve të pakategorizuara, njoftojnë Ministrinë lidhur me planin për ndërtim dhe lidhjet e këtyre rrugëve me rrugët magjistrale dhe rajonale.

14.3 Pronarët e rrugëve të pakategorizuara njoftojnë Drejtorinë me planin për ndërtim dhe lidhjet e këtyre rrugëve me rrugët lokale.

14.4 Pronarët e rrugëve të pakategorizuara që dëshirojnë të kenë qasje në rrugë magjistrale ose rajonale, duhet të sigurojnë leje nga Ministria.

14.5 Pronarët e rrugëve të pakategorizuara që dëshirojnë që këto rrugë të pa-kategorizuara të lidhen me rrugët lokale, duhet të sigurojnë pëlqimin nga DUPMM dhe më pas të sigurojnë leje nga Drejtoria.

14.6 Komuna dhe pronarët e rrugëve të pakategorizuara informojnë ministrinë me planin për ndërtim dhe lidhjet e rrugëve të tyre me rrugët magjistrale dhe regjionale.

14.7 Pronarët e rrugëve të pakategorizuara që dëshirojnë të kenë qasje në rrugë magjistrale ose regjionale jashtë hapësirave urbane, brenda territorit të komunës duhet të sigurojnë lejen nga Ministria.

Neni 15

15.1 Lejen për ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe objekteve përcjellëse, si dhe lejen e përdorimit për to, e jep DUPMM.

15.2 Për t'u pajisur me leje për ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugës dhe objekteve përcjellëse të rrugës, secili person fizik dhe juridik, duhet të parashtojë kërkesë pranë DUPMM sipas procedurës në bazë të ligjeve në fuqi për rrugët dhe për ndërtim, duke përfshirë:

- a) Projektin kryesor në pesë kopje të shtypura (si dhe në format elektronik, DWG dhe PDF);
- b) Certifikatën e pronësisë dhe kopjen e planit të parcelave ku shtrihet rruga publike;
- c) Pëlqimet e siguruara nga institucionet dhe ndërmarrjet publike që atakohen me trupin e rrugës dhe objektet e saj;
- d) Vendimin për fillimin e procedurës së shpronësimit të parcelës kadastrale ku do të ndërtohet rruga publike.

15.3 Rrugët publike ndërtohen me konstruksion për pranimin e ngarkesave boshtore prej së paku 115 kN (11.5 ton.) për një bosht të automjeteve. Në raste të veçanta, rrugët lokale mund të ndërtohen me konstruksion për pranimin e ngarkesave boshtore të automjeteve me të vogla, por jo me pak së 60 kN (6 ton.) për një bosht.

15.4 Në ura, tunele, viadukte dhe objekte të tjera të rrugës, gjerësia e sipërfaqes për qarkullimin e automjeteve nuk mund të jetë më e vogël se gjerësia e sipërfaqes për qarkullimin e automjeteve jashtë këtyre objekteve.

15.5 Vendndalimet e autobusëve në rrugët lokale duhet të ndërtohen jashtë sipërfaqeve për qarkullimin e automjeteve, ndërsa në rrugët që teknikisht nuk krijohen kushtet për ndërtimin e vendndalimit jashtë trupit të sipërfaqes qarkulluese, lejohet edhe vend-ndalja në shiritin qarkullues, me kusht që autoriteti lokal – Komuna këto vendndalime i përcakton dhe i pajis me shenja adekuate (shenjëzim horizontal, vertikal dhe ndriçim).

15.6 Autoriteti Lokal – Komuna duhet të formoj një komision profesional për përcaktimin e vendndalimeve për autobus.

15.7 Menaxhimin e procesit të ndërtimit dhe rikonstruktimit të rrugëve publike dhe objekteve të rrugëve brenda zonës urbane ose brenda territorit të komunës e kryen Menaxheri i Kontratës ose Ekipi për Menaxhim të kontratës, emëruar nga Kryetari i Komunës

15.8 Menaxheri i Kontratës ose Ekipi për Menaxhim të Kontratës monitorohen nga Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës, emëruar nga Kryetari i Komunës.

15.9 Menaxheri i kontratës ose Ekipi për Menaxhim të Kontratës, si dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës , duhet të emërohen pas nënshkrimit të kontratës dhe para fillimit të punëve për ndërtim apo rikonstruktim të rrugëve lokale publike dhe objekteve të rrugës.

15.10 Pranimi i përfundimit të punëve për ndërtim apo rikonstruktim të rrugëve publike dhe objekteve të rrugës bëhet pasi të bëhet inspektimi përfundimtar i punimeve, pas pranimi të punimeve nga MK apo EMK dhe vetëm pasi të jetë lëshuar ‘‘Certifikata e Pranimi Përfundimtar të Punimeve’’ e lëshuar nga Menaxheri i kontratës ose Ekipi për Menaxhim të kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës, duke u bazuar në dokumentet që përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Projektin kryesor, duke përfshirë specifikimet teknike, paramasën dhe parallogarinë;
- Projektin për infrastrukturën nëntokësore në trasenë e rrugës;
- Elaborati gjeodezik i shpronësimeve sipas rastit;
- Lejen e ndërtimit;
- Kontratën e ndërtimit;
- Planin e menaxhimit;
- Letrën për fillimin e punëve;
- Raportet e menaxhimit;
- Ditarin ndërtimor;
- Urdhëresat;
- Minutazhat e takimeve dhe diskutimeve të rregullta javore;
- Librin ndërtimor;
- Shqyrtimet laboratorike të punëve ndërtimore të secilës fazë;

- Atestet dhe Certifikatat e materialeve të përdorura;
- Mostrat e materialeve ;
- Raportet dhe certifikatat e aprovimit të materialeve nga MK apo EMK;
- Fotografitë gjatë zhvillimit të punimeve;
- Protokolet e fazave të ndërtimit;
- Shopdrawings;
- Projekti i zbatuar/ekzekutuar i dorëzuar në kopje fizike, DWG dhe PDF format.

Neni 16

16.1 Drejtoria në bashkëpunim me DUPMM dhe Ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, përgatitë një vlerësim mbi ndikimin në ambient, për çfarëdo propozimi të zhvillimit të rrugës që ka të bëjë me ndërtimin e rrugës publike.

16.2 Vlerësimi mbi ndikimin në mjedis përgatitet në pajtim me procedurën e paraparë me Ligjin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

16.3 Vlerësimi mbi ndikimin në mjedis duhet të përmbajë, por nuk është i kufizuar në informacione të veçanta vijuese:

- a) një përshkrim të propozimit të metodologjisë së ndërtimit të rrugës, duke përmbajtur informacione për pozitën, konstruksionin, masën, karakteristikat fizike dhe kriteret për përdorimin e tokës për ndërtim;
- b) të dhënat e nevojshme për të identifikuar dhe vlerësuar efektet kryesore që propozimi i ndërtimit të rrugës mund të ketë ndaj ambientit;
- c) një përshkrim të efekteve të mundshme të rëndësishme për ambientin lidhur me ndërtimin e rrugës së propozuar, dhe
- d) ku janë identifikuar efekte negative ndaj ambientit, përshkrimi i masave të parashikuara për të penguar, reduktuar dhe nëse është e mundshme, për të rregulluar këto efekte.

Neni 17

Drejtoria është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të trafikut si dhe shenjave të kufizimit të ngarkesave të lejuara mbi rrugët e ndërtuara lokale.

KREU V

SHFRYTËZIMI DHE MBROJTJA E RRUGËVE LOKALE

Neni 18

18.1 Rrugët publike lokale mund të shfrytëzohen për qarkullim nga të gjithë pjesëmarrësit në qarkullim rrugor, sipas kushteve të parapara me ligj.

18.2 Drejtoria e Inspektionit, në bashkëpunim me Drejtorinë, merr masa për:

- a) mbrojtjen e rrugëve nga dëmtimet, objektet ndërtimore rrugore dhe objektet për largimin e ujërave;
- b) mbrojtjen e sinjalizimeve;
- c) mbrojtjen e pajisjeve rrugore dhe objekteve të tjera që i shërbejnë rrugës;
- d) kontrollimin e ngarkesës, ngarkesat boshtore, dimensionet e automjeteve dhe kontrollimin e transportit të jashtëzakonshëm;
- e) ndalimin e ndërtimeve pa leje në pjesët e rrugës dhe brezin mbrojtës rrugor;
- f) Përcaktimin e kushteve për dhënien e lejes për transportim të jashtëzakonshëm.

18.3 Drejtoria është përgjegjëse për përcaktimin e kushteve dhe dhënien e lejes për transportim të jashtëzakonshëm.

Neni 19

19.1 Personi juridik ose personi fizik bën shkelje, nëse pa arsye dhe në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje:

- a) bllokon një rrugë lokale ose vendos ndonjë material në atë rrugë,
- b) pengon, ndërpre, shkurton ose në mënyrë tjetër dëmton rrugën lokale, në atë mënyrë që pamundëson shfrytëzimin normal të saj.

19.2 Kur gjykata shpall fajtor personin juridik ose fizik për shkelje sipas paragrafit 1 (a) dhe (b) të këtij neni, ajo obligon atë që të bëjë kthimin në gjendje të mëparshme.

Neni 20

20.1 Derisa ndërtimi ose mirëmbajtja është duke vazhduar në rrugën publike lokale, Drejtoria mund ta mbyllë atë për trafik, ndërsa kryesi i punimeve duhet të vendosë shenjë të qartë në atë pjese të rrugës lokale në të cilën puna është në kryerje e sipër.

20.2 Kur rruga lokale është e mbyllur, sipas paragrafit 1 të këtij neni, asnjë person nuk mund të hyje ose qarkulloje nëpër rrugë lokale, përveç nëse:

- a) është autorizuar nga drejtoria përkatëse,
- b) hyrjet ose udhëtimet në rrugë lokale janë në funksion të detyrës lidhur me ndërtimin ose mbarëvajtjen e punës që është duke u kryer në ata rrugë.

Neni 21

Rregullat e veçanta lidhur me peshat dhe dimensionet e automjeteve të cilat shfrytëzojnë rrugën publike, nxirren nga Ministria, duke përfshirë:

- a) rregullat e veçanta për çdo kategori të automjeteve;
- b) rregullat mbi mjetet kontrolluese për peshat e automjeteve;
- c) dispozitat ndëshkuese për shkeljet e rregullave për peshat dhe dimensionet;
- d) lejen e automjeteve për transport të jashtëzakonshëm.

Neni 22

- 22.1** Pronari i automjetit me mbingarkesë, i cili operon në rrugën publike, kryen kundërvajtje dhe përgjigjet nëse vepron në kundërshtim me nenin 21 të kësaj rregulloreje.
- 22.2** Pronaret e automjeteve mund t'i tejkalojnë rregullat e përcaktuara për peshat dhe dimensionet, vetëm nëse ata kanë leje nga Ministria për rrugët nacionale dhe rajonale.
- 22.3** Pronaret e automjeteve mund t'i tejkalojnë rregullat e përcaktuara për peshat dhe dimensionet, vetëm nëse ata kanë leje nga Komuna për rrugët lokale.
- 22.4** Pronari i automjeteve me mbingarkesë nëse nuk ka leje, duhet të ringarkojë ngarkesën e tij në një automjet tjetër para së të lejohet ta vazhdojë qarkullimin.

Neni 23

- 23.1** Në hapësirën e përcaktuar për brez mbrojtës rrugor, askush nuk mund të hapë minierë, të ndërtojë liqe artificial, fabrikë dhe instalime të ngjashme, në distancë më të vogël se:
- a) 100 metra nga autoudha,
 - b) 60 metra nga rrugët nacionale,
 - c) 40 metra nga rrugët rajonale dhe
 - d) 30 metra nga rrugët lokale.
- 23.2** Në hapësirën e përcaktuar për brez mbrojtës rrugor, askush nuk mund të ndërtojë objekte, rezidenca, zyra, puse, gropa septike, transmetues elektrik dhe instalime të ngjashme, në distance me të vogël se:
- a) 40 metra nga autoudha,
 - b) 20 metra nga rruga nacionale,
 - c) 10 metra nga rrugët rajonale dhe lokale.

Neni 24

- 24.1** Shfrytëzimi i rrugës publike lokale, pjesëve të saj, brezit rrugor dhe brezit mbrojtës për nevoja publike të përgjithshme, si vënia e kablllove të telekomunikacionit, gypave të ujit dhe lidhjeve ajrore dhe nëntokësore, duhet të jetë me pëlqimin dhe mbikëqyrjen e Drejtorisë.
- 24.2** Lejen për ndërtimin e instalimeve sipas paragrafit 1 të këtij neni, e jep DUPMM në koordinim me Drejtorinë.

Neni 25

- 25.1** Për shfrytëzimin e rrugës, pjesëve të rrugës ose objekteve të rrugëve lokale dhe brezit rrugor të këtyre rrugëve, Komuna mund të kërkojë kompensim.
- 25.2** Tarifa për shfrytëzimin e pjesëve të caktuara të rrugëve lokale, si dhe kategoritë e automjeteve dhe tarifatat për secilën kategori, i përcakton Drejtoria në bashkëpunim me Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik, përmes akteve nënligjore.

Neni 26

26.1 Në rast së është kryer ndonjë ndërtim, është vendosur ndonjë strukturë, instalim apo shenjë në rrugë, brezin rrugor apo në brezin mbrojtës rrugor, është ndërtuar qasja në rrugë lokale në kundërshtim me ligjin dhe këtë rregullore ose rregullat e kushtet e përmbajtura në leje, Drejtoria e Inspektionit duhet të kërkojë nga subjekti përgjegjës që ta lëvizë, ta largojë ose ta ndryshojë ndërtimin, strukturën, instalimin, shenjën ose qasjen në rrugën lokale (publike).

26.2 Vërejtja sipas paragrafit 1 të këtij neni, lëshohet në formë të shkruar dhe i dorëzohet pronarit ose pronarëve.

26.3 Rruga e cila kyçet në rrugën publike (lokale) të asfaltuar, duhet të ketë konstruksion të njëjte me atë të rrugës në gjatësi prej:

- a) pesëdhjetë (50) metra për kyçje në rrugë nacionale;
- b) tridhjetë (30) metra për kyçje në rrugë rajonale dhe
- c) njëzet (20) metra për kyçje në rrugë lokale.

26.4 Gjerësia e rrugës nga paragrafi 3 i këtij neni, duhet të jete së paku pesë (5) metra.

26.5 Shpenzimet për ndërtim dhe asfaltimin e kyçje i mbulon parashtruesi kërkesës.

Neni 27

27.1 Kushdo që shfrytëzon rrugët publike të kategorizuara duhet të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme që të mos dëmtojë rrugën publike, pjesët e saj, pajisjet, si dhe objektet në rrugën publike (lokale).

27.2 Në pajtim me këtë rregullore, ndalohet:

- a) të dëmtohet rruga lokale, objektet e rrugës, pajisjet e rrugës, të ndryshohet forma dhe të zihet sipërfaqja e rrugës ose e pjesëve që i takojnë;
- b) të dëmtohet, të zhvendoset, të hiqet sinjalizimi rrugor dhe çfarëdo objekti tjetër që i takon atij;
- c) të pengohet rrjedhja e lire e ujërave në kanale anësore dhe në pjesët përkatëse të grumbullimit dhe shkarkimit të ujit;
- d) të pengohet rrjedhja e lire e ujit, e cila shkarkohet në terrenin nën nivelin e rrugës;
- e) të qarkullojnë kafshët në rrugë, të kullosin në brezin rrugor;
- f) të hidhet ose grumbullohet dheu, materiale ndërtimore, mbeturina ose materiale të çfarëdo lloji në rrugët, brezin rrugor dhe në distancën prej pese (5) metra nga brezi rrugor;
- g) të depozitohen plehra në brezin rrugor;
- h) të sillet ose të shpërndahet baltë në rrugët nëpërmjet rrotave të mjeteve që vijnë nga hyrja ose degëzimet;
- i) të shfrytëzohet kanali i rrugës për ujitje të tokave përreth;

- j) të bëhet ndotja e rrugës përmes derdhjes apo rrjedhjes së mazutit, naftës, vajrave motorike, betonit, si dhe materialeve të tjera të yndyrshme;
- k) të vendosen drita apo mjete të tjera ndriçuese në rrugë apo përgjatë rrugës, të cilat do të pengonin apo rrezikonin qarkullimin;
- l) të bëhet djegia e qëllimshme e barishteve apo hedhurinave në rrugë apo në pjesët e saj;
- m) çdo lloj veprimi tjetër i cili dëmton rrugën publike apo pajisjen rrugore, apo bën pengimin apo rrezikimin e qarkullimit në rrugën publike;
- n) të vendose pengesa apo mjete tjera në rrugën publike, të cilat ndikojnë në zhvillimin e qarkullimit;
- o) të ngase automjet motorik pa gomat e fryra apo me vemeza, pa veshëse me sipërfaqe të rrafshta;
- p) ta bëjë tejkalimin e ngarkesës bartëse të lejuar dhe të kufizuar për kategorinë e rrugës dhe e shenjëzuar me shenjë për ngarkesën e lejuar;
- q) të ekzekutohen punime pa pëlqim ose kundërshtim me kushtet e dhëna të pëlqimit, jashtë brezit mbrojtës, me ç'rast mund të ndryshohet niveli i ujërave apo ngritja e ujërave nëntokësor ose në ndonjë mënyrë tjetër mund të ndikojë në rrugë, sigurinë në qarkullim rrugor;
- r) të derdhen ujëra dhe ujëra fekale;
- s) të bëhet lërimi dhe ekzekutimi i punëve bujqësore në bankina, pjerrësi dhe në brezin rrugor.

KREU VI

INSPEKTIMI

Neni 28

28.1 Zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e mbikëqyrë Drejtoria e Inspeksionit Komunal.

28.2 Ndërhyrjet në rrugë publike dhe në brezin mbrojtës rrugor të tyre e mbikëqyrin inspektorët komunal për ndërtim dhe urbanizëm në kuadër të kompetencave të tyre.

Neni 29

29.1 Drejtoria e Inspeksionit Komunal ka kompetencë të mbikëqyrë mirëmbajtjen e të gjitha rrugëve publike, në suaza të përcaktuara me dispozita unike të bazës profesionale për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike.

29.2 Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të kësaj rregulloreje, Drejtoria e Inspeksionit Komunal është kompetente:

- a) të bëjë kontrollimin e dokumentacionin teknik lidhur me ndërtimin, rikonstruktimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike dhe objekteve në këto rrugë;

- b) të bëjë kontrollimin e zhvillimit të punimeve në ndërtimin, rikonstruktimit, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike;
- c) të bëjë kontrollimin e materialeve me rastin e zhvillimit të punimeve, se a janë duke u zbatuar standardet, normat dhe kriteret teknike gjatë ndërtimit, rikonstruktimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve publike;
- d) të bëjë kontrollimin e plotësimit të kushteve për personat të cilët merren me projektim, dhe kontrollimin e dokumentacionit teknik, udhëheqjen, ekzekutimin e punimeve dhe mbikëqyrjen profesionale;
- e) të bëjë kontrollimin me rastin e ndërtimit, rikonstruktimit të rrugës publike, pjesëve të saj, si dhe objekteve rrugore, lejen e ndërtimit ose pëlqimin, dhe të konstatohet se a është lëshuar në mënyrë të rregullt;
- f) të bëjë kontrollimin e transportit të jashtëzakonshëm, si dhe të verifikohet leja për këtë transport;
- g) të vërtetojë se a është punëkryesi i ndërtimit dhe rikonstruktimit të rrugës publike, pjesëve të saj dhe objekteve në rrugë, duke e mbajtur në mënyrë të rregullt librin inspektues dhe ditarin ndërtimor;
- h) të bëjë ndërprerjen e punimeve që kryhen në kundërshtim me dispozitat ligjore, normat dhe standardet teknike gjatë zhvillimit të punimeve dhe përdorimit të materialit ndërtimor në mirëmbajtje, ndërtim dhe rikonstruktimin e rrugëve publike;
- i) të bëjë ndërprerjen e punimeve të cilat zhvillohen në afërsi të drejtpërdrejt të rrugës publike;
- j) të bëjë përjashtimin prej komunikacionit të automjetit, i cili qarkullon në rrugë publike pa leje për transport të jashtëzakonshëm;
- k) të urdhëroje mënjanimin e të metave të konstatuara në rrugën publike, të cilat e rrezikojnë zhvillimin e komunikacionit në rrugën publike;
- l) të urdhëroje ndërprerjen e punëve dhe rrënimin e objektit, i cili ndërtohet në brezin e rrugës dhe brezin mbrojtës të rrugës publike;
- m) të urdhëroje marrjen e masave për siguri të rrugës publike dhe të ndaloje përkohësisht komunikacionin për automjetet, të cilat për shkak të peshës së vet të përgjithshme, dimensioneve dhe veçorive tjera teknike, mund t'i shkaktojnë dëme rrugës publike ose të rrezikojë sigurinë e qarkullimit të automjeteve në rrugën publike;
- n) të ndalojë komunikacionin në rrugën e ndërtuar ose të rikonstruktuar, objektin e rrugës, ose në një pjesë të rrugës, nëse nuk është dhënë leja për përdorimin e rrugës publike apo objekteve të rrugës publike;

- o) të ndalojë përdorimin e parkingjeve ose rrugëve lidhëse, nëse janë ndërtuar pa leje ose në kundërshtim me lejen e dhënë;
- p) të ndërmarrë masat dhe veprimet për të cilat është i autorizuar me dispozita të veçanta.

Neni 30

Komuna mund ta themelojë shërbimin e përbashkët për mbikëqyrjen e rrugëve lokale me një apo më shumë komuna fqinje.

KREU VII

DËNIMET PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 31

31.1 Personi juridik dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej tremijë (3,000.00) € deri në njëzetmijë (20,000.00) €, nëse:

- a) ndërton një objekt brenda distancave të caktuara në nenin 23 të kësaj rregulloreje;
- b) kyçet në rrugën nacionale ose rajonale pa lejen e Ministrisë (neni 14, paragrafi 3) të kësaj rregulloreje;
- c) kyçet në rrugën lokale pa lejen e Komunës (neni 14, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje);
- d) vendos kablo të telekomunikacionit, gypa uji ose struktura të ngjashme pa pajtimin e Komunës (neni 24 i kësaj rregulloreje);
- e) Është pronar i një automjeti të mbingarkuar, që lëviz në një rrugë publike pa leje të veçantë (neni 22 i kësaj rregulloreje).

32.1 Personi fizik apo personi përgjegjës në personin juridik, i cili kryen shkeljet e caktuara, në nenin 31, paragrafi 1 i këtij neni, dënohet me gjobë prej pesëqind (500.00) € deri në dymijë (2,000.00) €.

Neni 32

32.2 Personi juridik dënohet për kundërvajtje, me gjobe prej dymijë (2,000.00) € deri në pesëmbëdhjetmijë (15,000.00) €, nëse:

- a) shfrytëzon apo dëmton rrugën publike, pjesët e saj, pajisjet dhe objektet e rrugës (neni 19 dhe 25 të kësaj rregulloreje);
- b) nëse nuk e kthen në gjendjen e mëparshëm rrugën, personi i cili është shpallur fajtor nga gjykata sipas nenit 19 dhe 25 të kësaj rregulloreje.

32.3 Personi fizik apo personi përgjegjës në personin juridik, i cili kryen shkeljet e cekura në nenin 32, paragrafin 1, dënohet me gjobë prej treqind (300) € deri në dymijë (2,000.00) €.

Neni 33

33.1 Personi juridik dënohet për kundërvajtje, me gjobe prej tremijë (3,000.00) € deri në dhjetmijë (10,000.00) €, nëse:

- a) rrugën e cila kyçet në rrugë publike të asfaltuar, nuk e ndërton në pajtim me distancat e caktuara në nenin 26, paragrafi 3 pikat a,b dhe c të kësaj rregulloreje;
- b) është pronar i një automjeti të mbingarkuar që lëviz në një rrugë publike në kundërshtim me kushtet e caktuara të lejes së jashtëzakonshme (neni 22 të kësaj rregulloreje);
- c) bën transportim të jashtëzakonshëm pa leje të posaçme;
- d) bën transportim të jashtëzakonshëm në kundërshtim me lejen;
- e) hyn në rrugë publike që është mbyllur pa marrjen paraprake të autorizimit (neni 20 të kësaj rregulloreje).

33.2 Personi fizik apo personi përgjegjës në personin juridik, i cili kryen shkeljet e cekura në nenin 33, paragrafin 1 i këtij neni, dënohet me gjobe prej treqind (300.00) € deri në një mijë (1,000.00) €.

KREU VIII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34

Rrugët lokale do të regjistrohen në Kadastër dhe Regjistrin e të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP), në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për RDPP.

Neni 35

Ditën e miratimit të kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja për rrugët lokaleXXXX

Neni 36

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT

XX. nr. XXXXXXXX, me XX.XX.XXXX